REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1442 Prot. Tiranë, më 14.08.2023

Lënda: *Kthim përgjigje.*

NAFISA HASANOVA
DREJTUESE E SKUADRËS KËRKIMORE, REGJISTRI GLOBAL I MEDIAS

KRISTINA VOKO
DREJTORESHË, BIRN ALBANIA

BIRN, Albania, Rruga "Nikolla Jorga", Kulla 8, AP.8, Tiranë

Të nderuar,

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj për vonesën në përgjigj, për shkak të ndryshimeve të fundit në Radio Televizionin Shqiptar, lutemi të gjeni në vijim të dhënat dhe informacion e kërkuar me shkresën tuaj *"Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit"*, administruar nga RTSH me nr. 1442 prot, datë 13.07.202.

Në përgjigje të pikës së parë të kërkesës, emrat e personave të cilët aktualisht mbajnë pozicione me ndikim në organet drejtuese të Radio Televizionit Shqiptar janë:

Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar

1. Leka Bungo	Kryetar
2. Gëzim Podgorica	Zv/ Kryetar
3. Genc Përmeti	Anëtar
4. Ilir Keko	Anëtar
5. Mevlan Shanaj	Anëtar
6. Milena Selimi	Anëtar
7. Ardita Reçi	Anëtar
8. Ëngjëll Ndocaj	Anëtar
9. Edmond Tullumani	Anëtar
10. Dionis Papadhimitri	Anëtar

Drejtor i Përgjithshëm

- Alfred Peza

Bordi i Administrimit

1. Knidi Bashari (i jashtëm) Kryetar
2. Vjollca Braho (i jashtëm) Anëtar
3. Valbona Lilaj Anëtar
4. Adriatik Braçe Anëtar
5. Dorian Shehi Anëtar

Bordi Artisik

1. Ormira Lulanaj Piktore
2. Rita Petro Shkrimtare
3. Xhuliano Hajdari Regjisor
4. Ilir Butka Kineast dhe producent filmash
5. Briseida Mema Gazetare

Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit

Albana Qehaja, Silvana Nini, Vasil Tole, Ardita Reçi, Florjan Rojba, Milena Selimi, Sinan Tafaj, Ervin Lera, Evis Bakshevani *(aktualisht vend vakant)*, Arben Lami, Ivana Tomço, Anastasi Prodani, Bardhyl Sejdarasi, Petraq Papa, Klaudio Pulaha

Zv/ Drejtor i Përgjithshëm z. Redi Neziri

Drejtues i Njësisë së Programeve znj. Bora Xhanija (e komanduar)

Drejtues i Njësisë Teknike z. Henri Muça

Drejtues i Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve *Aktualisht vend vakant*

Në përgjigje të pikës së dytë të kërkesës, bashkëlidhur do të gjeni Analizën e treguesve ekonomiko-financiar për vitin 2022 të përgatitur nga Drejtoria Ekonomike.

Lidhur më pikën e fundit mbi shikueshmërinë e RTSH-së, dëgjueshmërinë e Radio Tiranës, aktualisht, RTSh nuk e mundëson apo disponon një të dhënë të tillë. Në përgjithësi, ky është një shërbim që mund të ofrohet nga palë të treta dhe RTSH nuk ka ende një marrëveshje të tillë.

Sa i përket lexueshmërisë të faqes zyrtare *rtsh.al*, nga të dhënat që disponojmë, për periudhën Mars- Maj 2023 kjo faqe ka pasur rreth 356 mijë vizitorë unikë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Alfred Peza

REPUBLIKA E SHQIPËRISË TELEVIZIONI SHQIPTAR TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR
DREJTORIA EKONOMIKE

Tiranë, më___.___.2023

Lënda : Realizimi i treguesve ekonomiko- financiarë gjatë vitit 2022

Realizimi i treguesve të mësipërm analizohet duke u bazuar në Vendimin nr.7 datë 15 Mars 2022, mbi miratimin e buxhetit të RTSH për vitin 2022.

❖ Struktura e të ardhurave të RTSH gjatë vitit 2022

A. Struktura e të ardhurave të realizuara:

Në mënyrë të detajuar burimet, nëpërmjet të cilave RTSH ka realizuar të ardhurat gjatë kësaj periudhe janë:

BURIMI	Të ardhurat në 000 lekë
Financimi nga Buxheti i Shtetit 25.5%	567,600
Tarifa mbi Aparatin Marrës radio televiziv 57.5%	1,282,469
Kontratat e shfrytëzimit të infrastrukturës së transmetimit 5.3%	118,250
Reklamat, njoftimet kronikat etj 9%	217,057
Të ardhura të tjera, shitja e mat.arkivore, ripërsëritje transm, qira,dividente, grante etj. 2%	44,075
TOTALI	**2,229,450**

Në mënyrë të përmbledhur, të ardhurat sipas burimeve të financimit janë realizuar në raportet dhe në strukturën e mëposhtme:



B.Realizimi i të ardhurave në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2022:

ne mijë lekë

Nr	Emërtimi	Planifikimi i Vitit 2022	Realizimi Viti 2022	% e realizimit
I.	**Financimi nga buxheti**	**567,600**	**567,600**	**100.0%**
a	Bashkatdhetarët&Sateliti	240,000	240,000	100.0%
b	Projekte Filmike&Artistike	67,600	67,600	100.0%
c	Orkestra Simfonike RTSH	62,400	62,400	100.0%
d	Projekte Tekn.Teknologji te reja SLA	197,600	197,600	100.0%
II.	**Të ardhura nga tarifa aparatit TV.**	**1,429,190**	**1,282,469**	**89.7%**
III.	**Të ardhura te institucionit**	**346,250**	**379,382**	**109.6%**
a	Sherbim ambjente transmetuese,tr.fin	126,250	118,250	93.7%
b	Reklama,njoftime etj.	185,000	217,057	117.3%
c	Të ardhura të tjera	35,000	44,075	125.9%
TOTALI		**2,343,040**	**2,229,450**	**95.2%**

Të ardhurat janë realizuar në masën 95.2% në krahasim me planifikimin.

Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave në total prej 2,229.5 mln lekë dhe mungesat në vlerë absolute 113.6 mln lekë, analizohen më poshtë:

I-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në nivelin 100%.

a) Në Programin e parë Bashkatdhetarët dhe Shërbimi Satelitor, në zbatim të nenit 116/a,b,c të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i cili shprehimisht përcakton "Financimi nga Buxheti i Shtetit" perfshin :

a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;

c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

është tërhequr financimi në vlerën totale 240 mln lekë, duke u realizuar 100% .

b) Në Programin Projekte Filmike e Artistike, në zbatim të nenit 116/d të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i cili shprehimisht përcakton "Financimi nga Buxheti i Shtetit"/d) Projekte të rëndësishme prodhimi filmike dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja; është tërhequr financimi buxhetor në vlerën totale 67.6 mln lekë për projektet filmike e artistike parashikuar për vitin 2022: Eurosong 2022, Junior Eurosong, Festivalin e 61 të Këngës në RTSH, programet artistike, filmike, festive të fundvitit.

c) Në Programin e tretë Orkestra Simfonike e RTSH-së, në zbatim të nenit 116/dh të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i cili shprehimisht

përcakton "Financimi nga Buxheti i Shtetit"/ dh) orkestrën simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë, është tërhequr financimi në vlerë totale 62.4 mln lekë. Ndonëse shpenzimet janë tërhequr nga buxheti 100% në nivelin e planifikuar, në fakt RTSH ka plotësuar diferencën e shpenzimit të këtij zëri e cila nuk arrin të mbulohet nga financimi buxhetor.

d) Në Programin e Projekteve Teknike per futjen e Teknologjive te reja, në zbatim të nenit 116/ç të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i cili shprehimisht përcakton "Financimi nga Buxheti i Shtetit"/ ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim; parashikuar shpenzime për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit etj. në vlerën 197.6 mln lekë, nëpërmjet të cilës është likuiduar detyrimi kontraktor për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit gjatë vitit 2022. Në fakt vlera e parashikuar është ~64.6 mln lekë më pak se shpenzimi faktit bazuar në kontratën e shërbimit, e cila për vitin 2022 është në vlerën 262.2 mln lekë,

II. E ardhura nga tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv.

Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv është realizuar në vlerën 1,282 mln lekë ose në masën 89.7% në krahasim me planin vjetor, ose mungesë në vlerë absolute ~146.7 milion lekë. Gjatë vitit 2022, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa përfshijnë periudhën Janar -Dhjetor 2022, dhe këto të ardhura janë arkëtuar brenda periudhës së parashikuar mujore.

Mosrealizimi në këtë zë vjen kryesisht si rezultat i planifikimeve që bën RTSH në buxhet në fillim të vitit, bazuar në kërkesat për ndryshime ne udhëzimin e përbashkët nr.29, datë 18.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Radio Televizionit Shqiptar për tarifën e aparatit.

Konkretisht, është kërkuar ndryshimi i udhëzimit me:

- një rritje të tarifës deri në 200 leke nga 100 leke që është aktualisht.
- uljen e komisionit të agjentit tatimor (OSHEE), nga 10% në 2%.
- faturimi i shërbimit për përdorimin e aparateve televizive për përdoruesit jo-familjarë bazuar në numrin e aparateve/dhomave.

Gjatë tre viteve të fundit, arkëtimi i tarifës në muaj të veçantë ka rezultuar më i ulët se planifikimi dhe ka krijuar problematika në realizimin e të ardhurave të buxhetit të përgjithshëm, dhe për rrjedhojë edhe në shpenzimet e RTSH-së.

Risku në realizimin e kësaj të ardhure qëndron, si në arritjen e realizimit 100% të nivelit të planifikimit, ashtu edhe në atë që arkëtimet të kalojnë në fondet e RTSH-së brenda muajit korrent.

III.Të ardhurat e vetë RTSH-së janë realizuar në masën 109.6%.

a. Të ardhurat nga shërbimi në ambjentet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm janë realizuar në vlerën 118.250 mln lekë ose në masën ~93.7%, me një mungesë prej 8 milion lekë. Vlen të theksohet se një pjesë e operatorëve lokalë nëpër alokmente janë larguar nga rrjeti i RTSH, duke sjellë si rrjedhojë mosrealizim të ardhura të planifikuara në këtë zë.

b.Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj, janë realizuar në masën 117.3%, në vlerë 217.06 mln, me afro 32.1 mln realizim më shumë se planifikimi i periudhës.
Nga të ardhurat e kontraktuara gjatë vitit 2022, të ardhurat për eventin Fifa Ëorld Cup 2022 zënë rreth 66% (144 mln) të totalit të të ardhurave të këtij zëri gjatë vitit 2022.
Në mënyrë analitike të ardhurat e realizuara paraqiten:
-Drejtoria e Shitjes dhe Promocionit në vlerën 212.9 mln lekë;
-Qendra Vendore Audiovizive Korçë në vlerën 1.9 mln lekë;
-Qendra Vendore Audiovizive Gjirokastër në vlerën 1.8 mln lekë;
-Qendra Vendore Audiovizive Shkodër në vlerën 0.44 mln lekë.

c.Në zërin e të ardhurave të tjera janë realizuar të ardhurat e parashikuara në nivelin 125.9%, dhe vlerë 44.08 mln lekë. Në këtë zë janë përfshirë dhe zënë peshën kryesore të ardhurat nga dividenti si pjesëmarrje në kapitalin aksioner të shoqërisë Eutelsat në shumën 25.6 mln lekë. Gjithashtu ka të ardhura nga qiratë rreth 7.6 mln lekë, grante të huaja të përfituara 1.2 mln lekë, të ardhurat nga biletat e festivalit të fundvitit 4.2 mln lekë, të ardhura nga jashtë për të drejta etj në vlerën 5.4 mln lekë,

C. Realizimi i të ardhurave gjatë tre viteve të fundit:



në 000 leke

TE ARDHURAT	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
I Financimi nga buxheti	**633,134**	**573,736**	**567,600**
Bashkatdhetarët & Sateliti	270,000	220,000	240,000
Projekte Filmike&Artistike	60,000	60,000	67,600
Orkestra Simfonike RTSH-së dhe kinematografisë	54,000	60,000	62,400
Investime në Teknologji	69,134	17,736	
Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	180,000	216,000	197,600
II.Të ardhura nga tarifa ap.tv	**1,139,491**	**1,363,257**	**1,282,469**
III.Të ardhura të Institucionit	**225,727**	**296,943**	**379,382**
Të ardh. Shfrytezimi i Infrastrukturës Transmetuese	122,507	137,397	118,250
Reklama, njoftime etj.	78,460	143,546	217,057
Të ardhura të tjera	24,760	16,000	44,075
TOTALI I+II+III	**1,998,352**	**2,233,936**	**2,229,450**

Nisur nga të dhënat e tabelës:

-Të ardhurat nga financimi buxhetor paraqiten me ulje gjatë dy viteve të fundit.

-Të ardhurat nga tarifa shërbimit të përdorimit të aparatit tv paraqiten më të larta në vitin 2021, por në fakt në këtë vlerë në vitin 2021 është përfshirë edhe arkëtimi i vlerës 98 milion lekë që i përket muajit dhjetor 2020, e duhej të ish arkëtuar në vitin 2020 por është arkëtuar në janar 2021. Gjatë vitit 2022 të ardhurat nga ky zë kanë qenë në shumën 1,282 mln lekë.

-Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese paraqiten me të ulta gjatë vitit 2022, siç theksuam dhe më lart nga largimi i subjekteve nga allotmentet.

-Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj. paraqiten më të larta, dhe kjo ka të bëjë kryesisht me transmetimin gjatë këtij viti të eventit sportiv Fifa Ëorld Cup 2022.

-Të ardhurat e tjera paraqiten me rritje si rezultat i arkëtimit brenda vitit i të ardhurave nga Eutelsat që i përkasin dividentit të vitit korent por edhe atij të mëparshëm, e të ardhura të tjera të realizuara në vitin 2022.

D.Të drejtat e pritshme për arkëtim

Kliente për shitje dhe shërbime në vlerën 249.96 mln lekë, si në tabelën më poshtë:

Lloji i detyrimit te klienteve	Vlera
Të pritshme të arkëtohen (te ardhura teknike)	67,313,919
Të pritshme të arkëtohen (te ardhura marketing)	103,353,171
Detyrime në kontrata shkembimi	24,230,918
Detyrime në proces gjygjësor të pritshme të arkëtohen	12,329,693
QVA Korca	868,258
QVA Shkodra	10,000
QVA Gjirokastra	92,750
Detyrime kliente pa shprese arketimi	41,758,291
Totali llog.411	**249,957,000**

Nga sa më sipër *"Klientë"*, në vlerën prej 208,198,709 lekë në vitin 2022 përfshin të gjitha detyrimet e krijuara në Drejtorinë e Përgjithshme, dhe QVA Korçë, Shkodër, Gjirokastër. Kryesisht këto detyrime janë të likujduara, në proçes likujdimi në vijim, por një pjesë edhe në proçese gjyqësore e përmbarimore të pritshme për tu arkëtuar. Në mënyrë analitike detyrimet e klientëve dhe periudhat e lindjes së këtyre detyrime gjenden më poshtë:

Nr	Subjekti	Detyrimi	Periudha
1	Reparti Ushtarak	576,000	Dhjetor '22
2	A.M.A	164,700	Dhjetor '22
3	Iepv korca	36,000	Dhjetor '22
4	Drejtoria Kufirit Gjirokaster	36,000	Dhjetor '22
5	Drejtoria Kufirit Vlore	72,000	Nentor '22 Dhjetor' 22
6	Komanda e Forces Ajrore	72,000	Dhjetor '22
7	Drejtoria Policia Gjirokaster	36,000	Dhjetor '22
8	Banka e Shqiperise	180,000	Dhjetor '22
9	Shish	108,000	Dhjetor '22
10	Radio klan	118,253	Dhjetor '22
11	Rozafa	144,000	Shtator 22 Dhjetor'22
12	UNDP	60,000	Dhjetor '22
13	ATSH	120,000	Dhjetor '22
14	Media SHA TV Shijak	10,313,234	Prill'20-Dhjetor '22
15	Fax Media News	6,082,343	Mars '21-Dhjetor'22
16	Multiscreen shpk	8,514,722	Shtator 22- Dhjetor'22
17	3DS& AF Entertatinment	5,231,589	Nentor '21-Dhjetor '22
18	6+1 Vlora shpk	3,276,419	Janar -Dhjetor '22
19	Fokus Media	2,382,047	Shtator' 22 Dhjetor'22
20	Media Motiv	3,526,183	Nentor '21-Dhjetor '22

21	Star News rtv	2,231,539	Tetor 21- Dhjetor 22
22	FKT shpk TV Apollon	607,603	det '19 + 1-15 Shtator'22
23	TV Premium Channel	1,906,862	Tetor' 22- Dhjetor'22
24	TV Sot 7	817,485	Shtator '22- Dhjetor '22
25	UTV Education	704,129	Tetor'21 Mbyll
26	Panorama	695,580	Nentor'21 Mbyll
27	Channel 7	1,554,260	Prill 21- Dhjetor 22
28	Media BS	1,902,782	Prill '22-Dhjetor '22
29	One TV Vlora	2,710,196	Tetor 21- Dhjetor '22
30	AMG 2000	581,504	Maj'22- Dhjetor '22
31	Antena Nord	414,850	Nëntor-Mars'22 Mbyll
32	TV Kopliku	1,886,624	Shkurt -Dhjetor '22
33	Johaniter	271,665	Janar '21
34	R&T shpk	180,000	Janar-Maj '21 Mbyll
35	Lulezim Ahmetaj	180,000	Gusht 22 Dhjetor '22
36	TV KLAN	1,324,036	Dhjetor '22
37	Alban Shehu	105,740	Dhjetor '22
38	Media Nord	464,915	Tetor '22 Dhjetor '22
39	Egnatia tv club tv	658,150	Dhjetor '22
40	Vodafon	319,396	Gusht - Shtator 22
41	Ovation Advertising	1,323,557	Shtator 22 Dhjetor' 22
42	One communication	9,332,159	Shtator 22 Dhjetor' 22
43	Landmark communications	197,140	Pjes.'18,Shtator'20
44	Eurosig	9,540,427	Dhjetor'19,Dhjetor '22
45	Birra Tirana	50,000	Viti 2018
46	Red Bull	1,423,752	Shtator 22-Dhjetor '22
47	Glen Deda	452,954	Dhjetor ' 19
48	Artmotion	1,432,241	Dhjetor 22
49	Unlimited Media	32,197,315	Shtator 22 Dhjetor '22
50	2 F GROUP	10,600	Shkurt 22
51	Digitalb	1,050,266	Mars '22-Dhjetor 22
52	Berlin Chemie	168,220	Korrik '22
53	Drejtoria e trashegimnise kulturor	9,600	Viti 2018
54	digicom	1,352,291	Dhjetor' 22
55	Neutron	23,614	Dhjetor '21
56	Bashkia KUKES	10,999	Qershor 22
57	E.H.W	349,610	Viti '21 Dhjetor 22
58	NEW MOMENT	717,974	Tetor 22-Dhjetor 22
59	Raiffaisen Bank	110,024	Shtator 22-Dhjetor 22
60	AK INVEST	4,302,211	Dhjetor 22
61	Beata	49,480	Gusht 22
62	OPTIMUM Media	67,840	Gusht 22
63	1 UP	234,200	Dhjetor 22
64	Aled shpk	43,262	Korrik 22
65	Grisilda Llukacej	43,262	Korrik 22
66	Arilta B	119,306	Dhjetor 22
67	Toni Metanj	120,000	Tetor '22- Dhjetor '22
68	Ariola Isufaj	26,500	Nëntor '22

69	Ogilvy	310,584	Nëntor '22
70	Qafshtama	1,417,255	Dhjetor 22
71	QTU	1,348,707	Dhjetor 22
72	FIX PRO	1,229,711	Nëntor ' Dhjetor 22
73	EURO BALCANS	982,968	Nëntor '22
74	Nisatel	556,380	Nëntor '22
75	Ambasada Italiane	2,247,618	Dhjetor 22
76	Altrechem	674,347	Dhjetor '22
77	Top Albania Radio	1,702,569	viti 21'- gusht '22
78	Banka Amerikane e investimeve	723,977	Dhjetor' 22
79	Tirana Bank	2,176,103	Dhjetor' 22
80	Gogel	400,590	Dhjetor' 22
81	Sport media music	4,036,120	Dhjetor' 22
82	Coca cola	627,520	Dhjetor' 22
83	Alfa sa	28,620	Dhjetor' 22
84	Top chanel	983,388	Dhjetor' 22
85	Mindshare albania	4,342,410	Dhjetor' 22
86	Intermedica	769,574	Dhjetor' 22
87	Teg	1,029,973	Dhjetor' 22
88	Banka credins	232,460	Dhjetor' 22
89	E BUSSINES SOLUTIONS	3,404,499	Dhjetor' 22
90	Unioni Financiar	5,454,495	Dhjetor' 22
91	Over sport	2,891,511	Dhjetor' 22
92	Marina rezidence	1,456,306	Dhjetor' 22
93	Intesa san paolo	715,613	Dhjetor' 22
94	Pajtoni shpk	1,213,912	Dhjetor' 22
95	Tona alb	849,738	Dhjetor' 22
96	Rhg	335,695	Dhjetor' 22
97	Bogo grup	470,522	Dhjetor' 22
98	Unicoms	219,658	Dhjetor' 22
99	Ardit Mulla	199,386	Dhjetor' 22
100	Conad	256,149	Dhjetor' 22
101	Management hopsit	63,600	Dhjetor' 22
102	Air Albania	1,867,614	Dhjetor' 22
103	Aerd	26,500	Dhjetor' 22
104	internac food	26,500	Dhjetor' 22
105	Spar Albania	1,483,930	Dhjetor' 22
106	Gener 2	276,000	Dhjetor' 22
107	Media Union	5,631,045	ne kontrate shkembimi e detyrime
108	Extra Channel	1,223,586	ne kontrate shkembimi
109	Deutsch Color	1,922,397	ne kontrate shkembimi
110	Veko	1,064,869	ne kontrate shkembimi
111	Tabacco Holding	2,005,266	ne kontrate shkembimi
112	Sigal	1,724,264	ne kontrate shkembimi
113	Auto Master	285,351	ne kontrate shkembimi
114	Aza Elektroshtepiake	337,049	ne kontrate shkembimi
115	Megatek	6,423,411	ne kontrate shkembimi
116	Dast	5,556,106	ne kontrate shkembimi

117	Media Art	134,994	procese gjyqesore e permbarimere
118	Centrum Production	375,333	procese gjyqesore e permbarimere
119	Kompania MCDR Shiroka	400,000	procese gjyqesore e permbarimere
120	Star Airways Albania	157,205	procese gjyqesore e permbarimere
121	2 AL shpk	815,000	procese gjyqesore e permbarimere
122	Menocon internet	292,000	procese gjyqesore e permbarimere
123	KESH	499,500	procese gjyqesore e permbarimere
124	"ALSAT" sh.a.	115,720	procese gjyqesore e permbarimere
125	Alfatelekom	918,000	procese gjyqesore e permbarimere
126	Teknomedia Neser TV	1,492,639	procese gjyqesore e permbarimere
127	Shoqeria Ora sha	146,121	procese gjyqesore e permbarimere
128	Shoqeria Channel one shpk	510,829	procese gjyqesore e permbarimere
129	Gener 2	1,062,880	procese gjyqesore e permbarimere
130	Tv Kukes	631,954	procese gjyqesore e permbarimere
131	BBF Marveshje	2,115,078	me marreveshje
total			**208,198,709**

"Klientë pa shpresë arkëtimi", me vlerë totale *41,758,291 lekë*, e cila përmban detyrime të mbartura nga Njësia Teknike me një shumë detyrimi të paarkëtuar nga subjektet debitore në vlerën 1,168,635 lekë (krijuar në ish drejtoritë e Radio Tiranës dhe Drejtoria Stacioneve Transmetuese RTSH para vitit 2000) Këto subjekte janë listuar në llogarinë 416 në mënyrë analitike paraqiten si në tabelat më poshtë:

Klienti	Vlera
ADA AIR	58,320
Administrata Publike	7,200
Insituti I Sigurimeve	291,690
Publimedia	617,231
Drejt.Stac.rtv	194,194
TOTALI Llog.416	**1,168,635**

Si edhe Drejtoria e Përgjithshme e RTSH rezulton me një shumë detyrimi të paarkëtuar nga subjektet debitore në vlerën 40,589,656 lekë të periudhës 2004-2005, detyrime këto për disa nga të cilat ka kaluar afati i parashkrimit.

Klienti	Vlera
Media 99	5,368,500
TV Arbëria	11,656,824
Radio Butrinti	630,000
Agjensia De&Ca	14,224,654
Agjensia Galaxy	1,625,000
Media 6 TV KLAN	3,444,054
Top Albania	3,640,624
Totali i subjekteve Llog.416	**40,589,656**

Lista e subjekteve me detyrimet përkatëse relatohet rregullisht në Drejtorinë e Shitjes dhe Promocionit dhe në Drejtorinë Juridike. Sikurse është vepruar edhe vitet e tjera, për disa subjekte kanë nisur procedurat për ndjekjen e detyrimeve në rrugë gjyqësore.
Vlen të theksohet se RTSH gjithashtu ka të drejta të pritshme për arkëtim nga institucione në fund të vitit 2022 në vlerën 371 mln lekë me një rritje prej 41 mln lekë nga viti 2021, dhe këto të drejta përfaqësojnë detyrimin tatimor të shtetit ndaj RTSH-së për TVSH-në kreditore.

Në kushtet kur RTSH përballet me kostot tepër të larta të procesit të digjitalizimit, shtimit të numrit të kanaleve të transmetimit e larmishmërisë së programacionit, mos financimi buxhetor bazuar në kërkesat e RTSH për shpenzimet faktike të politikave e programeve buxhetore, krijon vështirësi në stabilitetin financiar të RTSH-së.

❖ **Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2022:**

Nr	Emertimi	Planifikimi Viti 2022	Realizimi Viti 2022	Realizimi ne ne %
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqeror	908,220	885,685	98%
2	Materiale,lende djegese	54,140	55,245	102%
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav.	326,190	324,467	99%
4	Organizma Nderkombetar	84,000	88,890	106%
5	Shërbime nga të tretë	256,390	252,156	98%
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	56,250	40,409	72%
7	Shpenzime të tjera operative	58,850	58,489	99%
8	Investime dhe miremb. rrjeti digj.	275,000	262,198	95%
	Totali pa kestin e kredise	**2,019,040**	**1,967,539**	**97%**
9	Shpenz.këste e interesa kredie	324,000	0	
	TOTALI	**2,343,040**	**1,967,539**	**84%**

Shpenzimet e RTSH-së gjatë vitit 2022 janë realizuar në nivelin 97%.

Struktura e shpenzimeve paraqitet në mënyrë grafike:



**Shpenzimet për Paga, si dhe Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore* në total për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 paraqiten me një ulje në vlerë prej afër 29.9 mln lekë më pak, dhe përbën 45% të shpenzimeve të RTSH-së. Vendimi Nr.34, datë 07.12.2022 i Këshillit Drejtues për ndryshimin e pagave të RTSH ka hyrë në fuqi në Janar 2023. Bazuar në strukturën aktuale në fuqi numri faktik nga 1039 vënde pune në fund të vitit 2022 ishte 970.

**Zëri Materiale, lëndë djegëse* përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse, lëndë djegëse (karburant), realizuar në vlerën 55.1 mln lekë, dhe 5.7 mln më pak se viti 2021. Peshën më të madhe të realizimit në këtë zë e zënë shpenzimet për furnizimin me karburant për jjeneratoret në stacionet e radiostacionet e Njësisë Teknike si dhe karburant për automjetet. Për sa i takon shpenzimeve të tjera për zërat materiale, shpenzimet kryesore lidhen kryesisht me blerjet material teknike dhe ndihmese për Sektorin elektrik, Sektorin e transmetimit, IT, Orkestrën Simfonike RTSH, Departamentin e Prodhimit, blerje kanceleri dhe bojra printer, blerje për Automjete, blerje materiale kozmetike, detergjente, dizifektues, hidraulike, etj

**Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike & Fondi i prodhimit të pavarur*, është realizuar 99% në vlerën 324.5 mln lekë, e cila me vitin 2021, shënon një rritje prej 8.8 mln lekë më shumë. Dhe përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive e artistike. Këtu është përfshirë blerja e të drejtave sportive për aktivitetet Botërori 2022, Formula 1, Uefa Champions League, likuiduar sipas kuotave të parashikuara për vitin 2022, Po ashtu përfshihen blerje të drejta transmetimi dokumentarë, projekte filmike e artistike, bashkëprodhime.

Zëri i Organizmave Ndërkombetarë përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare, si Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor, EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, lajme, pagesat e kuotizacioneve ndaj organizmave ndërkombëtare, EBU, Circom, Copeam, Rai, URT, AFP, Kosova Press, Erno etj. Realizimi i këtij zëri gjatë vitit 2022 është në vlerën 88.9 mln lekë, ose në masën 106%, dhe 2,7 mln lekë më shumë se viti i kaluar.

Zëri i Shërbimeve nga të tretë përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, qira të ambjenteve, si dhe shpenzime të tjera. Realizimi i këtij zëri është në nivelin 98%, në vlerën 252.1 mln lekë, ose 12.8 mln më pak se viti 2021. Peshën më të madhe në këtë zë e përbëjnë shpenzimet për energji e ujë në shumën rreth 171 mln lekë.

Zëri i shpenzimeve Udhëtim e dieta është realizuar në masën 72%, në vlerën 40.4 mln lekë. Ka një zbritje në të njëjtat shpenzime të periudhës së kaluar në shumën 20.7 mln lekë.

Zëri i shpenzimeve të tjera Operative është realizuar në nivelin 99%, 58.5 mln lekë, ose 8 mln më pak se viti 2021. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pagesat e organeve drejtuese, pagesat e kujdestarëve të stacioneve transmetuese, pagesa për autoritete të lidhura me aktivitetin, pagesa taksa lokale e automjetesh, pagesa të ndryshme të stinës koncertore, etj.

Zëri i shpenzimeve për Investime dhe mirëmbajtje të rrjetit të digjitalizimit në zbatim të kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit realizuar
në vlerën 262.2 mln lekë, në masën 95%. Diferenca në këtë zë krahasuar me planifikimin vjen si rrjedhojë e uljes së kursit të këmbimit kundrejt lekut për monedhën në të cilën paguhen.
Investimet në shumën 10.99 mln lekë konsistojnë kryesisht në blerje pajisje zyre e informatike.

**Zëri i shpenzimeve të kësteve dhe interesave të kredisë nuk është realizuar* si rezultat i mungesës së të ardhurave, pamundësisë financiare të RTSH-së për përballimin e këtij shpenzimi, relatuar në të gjitha shkresat dërguar në Ministrinë e Financave.

.Krahasimi i Shpenzimeve të RTSH gjatë tre viteve të fundit

Emertimi	Realizimi Viti 2020	Realizimi Viti 2021	Realizimi Viti 2022
Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	824,569	915,597	885,685
Materiale,lëndë djegëse	67,964	61,000	55,245
Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	307,526	315,684	324,467
Organizma Ndërkombëtarë	86,066	86,161	88,890
Shërbime nga të tretë	225,755	264,959	252,156
Shpenzime udhëtimi e dieta	61,469	61,127	40,409
Shpenzime të tjera operative	61,050	66,576	58,489
Investime dhe mirëmb. rrjeti digj.	344,647	287,982	273,186
TOTALI	**1,979,046**	**2,059,086**	**1,978,527**

Paraqitja grafike e shpenzimeve gjate tre viteve te fundit:



Nga krahasimi në vite ndryshimet në zëra paraqiten :

- Ulje në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- Ulje në shpenzimet për blerje materialesh e lëndë djegëse pothuajse në të njëjtën shumë nga viti në vit.
- Një rritje prej afro 9 mln nga viti në vit për zërin e projekteve filmike, artistike, blerje të drejtash
- Pagesat për organizmat ndërkombëtare kanë një rritje të lehtë gjatë vitit 2022 në krahasim me dy vitet paraardhës.
- Në zërin e shërbimeve nga të tretë ka një ulje nga viti 2021.
- Shpenzimet për udhëtime e dieta kanë një ulje të konsiderueshme nga dy vitet e mëparshëm ku kanë qenë në të njëjtin nivel.

- Shpenzimet e tjera operative janë 8 mln më pak se të njëjtat shpenzime se në vitin 2021dhe 2.5 mln më pak se viti 2020.
- Në zërin e shpenzimeve për investime dhe mirëmbajtjen e rrjetit digjital ka ulje, kryesisht ndaj vitit 2020 për mungesë të fondeve për investime, dhe ulje ndaj vitit 2021 kryesisht për shkak të uljes së kursit të këmbimit të monedhës me të cilën paguhet mirëmbajtja e mirëmbajtjes së rrjetit digjital ndaj lekut.

DETYRIMET E RTSH NDAJ TË TJERËVE NË 31.12.2022

RTSH mbart detyrime në 31.12 2022:

- Për furnitorë në vlerën 129,26 mln lekë nga 135,39 mln lekë në fund të vitit 2021, me një pakësim prej 6,13 mln lekë. Detyrimi në fund të vitit 2022 përfshin detyrimet e krijuara në përgjithësi në fundvit 2022 dhe kryesisht të likujduara në fillim të vitit 2023.

Në mënyrë të përmbledhur sipas zërave të tyre detyrimet e RTSH-së ndaj furnitorëve përbëhen nga detyrimet për mirëmbajtjen e rrjetit të Digjitalizimit, Platformave Digjitale, e mirëmbajtje 54.74 mln lekë, detyrimet për blerje të drejtave Sportive dhe Filmike 38,27 mln lekë, detyrimet e periudhës së fundvitit për Fest 61 si dhe projekte të tjera, por edhe detyrimet e tjera mujore periodike.Gjithashtu RTSH ka edhe detyrime ndaj furnitorëve të mbartura nga Njësia Teknike që ndërkohë janë në ndjekje e në proçese gjyqësor për shumën 8,71mln lekë.

- Për personelin në vlerën 56,80 mln lekë në datë 31.12.2022, paraqiten detyrimet për pagat e punonjësve të gjithë strukturës të paguara në muajin Janar 2023.

- Për Detyrime ndaj shtetit për tap e sigurime shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor 2022 (paguhen janar 2023) në vlerën 22.84 mln lekë.

- Për vlerën e kredisë ndaj Deutsche Bank me principal 20,06 Euro, vlera e mbetur më 31.12.2022, mbas kryerjes së pagesave të kësteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është 644.85 mln lekë (5,33 mln eur).

- Për detyrimin ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këstet e paguara nga ajo për kredinë është në shumën 1,513.9 mln lekë.

GJENDJA E MJETEVE MONETARE TË RTSH NË 31.12.2022

Gjendja e mjeteve monetare të RTSH në datën 30.09.2022, paraqitet si vijon:

BANKA	MONEDHA	GJENDJE	GJENDJE NE LEKE
AMERICAN BANK OF INVESTIMENTS	ALL	7,450	7,450
BANKA KOMBETARE TREGTARE LEKE	ALL	519,247	519,247
CREDINS BANK LEKE	ALL	5,448,386	5,448,386
PROCREDIT BANK	ALL	7,051	7,051
RAIFFEISEN BANK	ALL	101,647,764	101,647,764
TIRANA BANK LEKE	ALL	26,444	26,444
UNION BANK LEKE	ALL	89,608,744	89,608,744
BANKA RAIFFEISEN CHF	CHF	3,149	211,099
BANKA KOMBETARE TREGTARE EURO	Euro	138,326	16,008,856
Llogari ne euro RBAL MC	Euro	717	87,258
RAIFFEISEN BANK EUR	Euro	233,228	26,482,593
UNION BANK EURO	Euro	20,297	3,057,750
BANKA RAIFFEISEN GBP	GBP	8,909	1,133,829
CREDINS BANK USD	USD	334	35,377
BANKA RAIFFEISEN USD	USD	24,917	2,634,012
RTSH GJIROKASTER RBAL	ALL	23,640	23,640
RTSH KORCE RBAL	ALL	314,450	314,450
RTSH KUKES RBAL	ALL	15,277	15,277
RTSH SHKODER UNION	ALL	105,750	105,750
TOTALI			**247,374,975**

Gjendja e mjeteve monetare në banka në datë 31.12.2022 rezulton me një rritje prej 199.3 mln lekë në krahasim me vitin paraardhës, dhe kjo kryesisht si rrjedhojë e arkëtimit të taksës së aparateve televizivë në ditët e fundit të vitit 2022.

RTSH gjatë gjithë vitit 2022 ka ndjekur hap pas hapi situatën financiare, duke likuiduar vetëm shpenzimet e domosdoshme për të realizuar detyrimet kontraktore brenda afateve.